

Banka e Shqipërisë publikon statistikat e harmonizuara të normave të interesit**Gusht 2020**

Në përmbushje të funksionit dhe përgjegjësi të saj si prodhues statistikash monetare dhe financiare, Banka e Shqipërisë harton statistikat e normave të interesit si pjesë e statistikave monetare. Statistikat e normave të interesit të institucioneve monetare financiare¹ (IMF) mbulojnë një gamë të gjerë të normave të interesit që institucionet e kreditit aplikojnë për depozitat dhe kreditë. Ato ndihmojnë në analizën e mekanizmit të transmetimit të politikës monetare, veçanërisht në vlerësimin e përcjelljes së politikës monetare të bankave qendrore - vendimet e tyre mbi normën bazë të interesit - në normat e kreditimit dhe depozitave, të cilat bankat i aplikojnë për klientët e tyre: ekonomitë familjare (individët) dhe korporatat jofinanciare. Normat e interesit të depozitave kryesisht tregojnë sesi individët kompensohen për kursimet e tyre si pjesë e komponentëve të stokut të parave, ndërsa normat e huasë përdoren për të vlerësuar kushtet e financimit të ekonomisë në tërësi.

Në kuadër të negociatave për anëtarësim në Bashkimin Evropian (BE), një nga detyrat kryesore të Bankës së Shqipërisë në fushën e statistikave është harmonizimi i legjislacionit të saj dhe standardeve të raportimit me kërkesat e BE-së. Në përmbushje të këtij detyrimi, BSH prej fundit të vitit 2017 filloi të zhvillojë një qasje të re në statistikat e normave të interesit. Kjo qasje e re është prezantuar në vendet evropiane në vitin 2003, përcaktuar në Rregulloren ECB/2001/18² dhe ndryshimet e saj³. Statistikat e harmonizuara

të normave të interesit të institucioneve monetare financiare, i kanë siguruar Eurosistemit informacion të vlefshëm për analizimin e zhvillimeve monetare dhe mekanizmit të transmetimit monetar, si dhe për monitorimin e stabilitetit financiar.

Standardi i ri metodologjik i statistikave të normave të interesit të IMF-ve (bankave) prezanton një sërë treguesish të rinj lidhur me fluksin e kredisë/depozitës së re, si dhe tepicën e kredisë/depozitës, të cilat zgjerojnë ndjeshëm bazën e të dhënave aktuale dhe hapin mundësi të reja analitike. Informacioni shtesë jo vetëm që lejon një studim më gjithëpërfshirës të mekanizmit të transmetimit monetar dhe zhvillimeve në disa segmente të tregjeve financiare, por gjithashtu, siguron një pasqyrë të re për aspektet e rrezikut që janë të rëndësishme për analizën financiare të stabilitetit të sistemit. Statistikat e reja të normave të interesit u mundësojnë politikëbërësve marrjen e një vendimi bazuar në një informacion të standardizuar, lehtësisht të krahasueshëm dhe cilësor; ekspertëve të ekonomisë, akademikëve dhe kërkuesve shkencorë të analizojnë kanalën e kredisë në mekanizmin e transmetimit të politikës monetare; si dhe i ofrojnë publikut të gjerë njohuri mbi normat e interesit - kostot dhe benifitet që aplikohen në sistemin bankar për instrumentet financiare.

Në shtator 2017, Banka e Shqipërisë miratoi rregulloren “Për raportimet në Bankën e Shqipërisë të statistikave të normave të interesit”, me vendimin nr. 48, datë 6.9.2017. Raportimi i parë i të dhënave nga bankat filloi në dhjetor 2017. Megjithatë, periudha “dhjetor 2017 – nëntor 2018” konsiderohet si konsolidimi e raportimeve sipas metodologjisë së re. Për këtë arsye, publikimi i statistikave të reja të normave të interesit do të fillojë nga muaji dhjetor 2018.

¹ Në llogaritjen e statistikave të normave të interesit, merren parasysh vetëm normat e interesit të depozitave dhe kredive të përdorura nga institucionet monetare financiare (bankat e nivelit të dytë) ndaj individëve dhe korporatave jofinanciare.

² Rregullorja (EC) Nr. 63/2002 e BQE e datës 20 dhjetor 2001 lidhur me statistikat për normat e interesit të aplikuara nga institucionet monetare financiare për depozitat dhe kreditë përkundrejt individëve dhe korporatave jofinanciare.

³ Amendime me ndryshime domethënëse: Rregullorja (EC) Nr. 1072/2003, 24.9.2013 (ECB/2013/34), amenduar në rregulloren e BQE-së të datës 8.7.2014 (ECB/2014/30), në lidhje me statistikat e normave të interesit të aplikuara nga institucionet financiare monetare (IMF), përveç Bankës Qendrore, dhe fondeve të tregut të parasë, për depozitat dhe huatë ndaj individëve dhe korporatave jofinanciare.

Ky publikim i ri statistikor zëvendëson statistikat aktuale të BSH-së mbi normat e interesit të kredisë dhe depozitave të reja, të cilat ndër vite kanë qenë me interes për shumë segmente të sektorit privat.

Metodologjia për mbledhjen e statistikave ka ndryshuar rrënjësisht, duke shkaktuar ndërprerje statistikore të pashmangshme në seritë kohore të ofruara për publikun. Në vijim, shpjegohen ndryshimet metodologjike në statistikat e normës së interesit, si dhe përshkruhen përfitimet analitike të kategorive të reja të prezantuara në këtë publikim, duke u ndalur në interpretimin e dy grupeve të statistikave.

METODOLOGJIA E RE⁴

Përvetësimi i standardeve evropiane për statistikat e normave të interesit ka sjellë një sërë ndryshimesh në përllogaritjen e normave për sasinë e re, si dhe *prezantimi për herë të parë i normave të interesit për sasinë gjendje të kredisë/depozitave të përcaktuara në normën mesatare të ponderuar dhe stokun korrespondues për të gjitha depozitat dhe kreditë ndërmjet individëve/korporatave jofinanciare dhe IMF-ve në ditën e fundit të muajit*. Përfundim nga kjo përllogaritje përbëjnë kreditë me probleme dhe kreditë për ristrukturimin e borxhit me norma nën kushtet e tregut - normat e interesit të dakordësuara në këto raste nuk janë rezultat i kërkesës dhe ofertës së përgjithshme të kushteve të tregut në kohën e marrëveshjes, por bazohen në aftësinë paguese të klientit.

Disa nga risitë metodologjike përmbledhin zëra të rinj për kredinë sipas: (i) qëllimit; (ii) prezantim për herë të parë i klasifikimit të instrumenteve, sipas afatit fillestar të maturimit, afatit të mbetur dhe periudhës së fiksimit të normës së interesit; (iii) prezantim për herë të parë i konceptit të normës vjetore të pranuar (AAR) dhe normës efektive të interesit sipas përkufizimit të ngushtë (NDER); (iv) përcaktimit të sasisë së re (fluksit të ri) sipas përkufizimit të BQE-së, ku përfshihen kontratat e reja gjatë periudhës raportuese si dhe kontratat ekzistuese midis bankës dhe klientit kur këta bien dakord për kushte të reja në kontratë

(rinegoci); (v) prezantim për herë të parë i aplikimit të normës së interesit sipas konceptit të madhësisë së kredisë për korporatat jofinanciare.

Në të njëjtën kohë, dimensiononi i informacionit të mbledhur në këtë kuadër metodologjik është i pasuruar me identifikimin si kategori të veçanta të:

Borxhit të zgjeruar të kartave të kreditit. Vitet e fundit, borxhi i kartës së kreditit është bërë më i rëndësishëm dhe ka tërhequr vëmendjen e analizës në periudhën pas krizës financiare globale. Statistikat e reja të normave të interesit e paraqesin këtë kategori më vete, në mënyrë që të mund të analizohet veçmas. Më parë, borxhi i kartës së kreditit raportohej shpesh së bashku me overdraftet, pa asnjë dallim midis dy llojeve të kreditimit, pavarësisht nga fakti se ato mund të ndryshojnë dukshëm nga njëri-tjetri në kushtet e normave të interesit. Të dhënat e reja mundësojnë monitorimin e normave të interesit për këtë lloj kredie edhe për qëllime të stabilitetit financiar – lidhur me efektet e mundshme të tërheqjeve në nivelin e borxhit të familjeve.

Regjistrimit të veçantë të të vetëpunësuarve. Të vetëpunësuarit, për herë të parë do të renditen si kategori e veçantë nën kategorinë individë. Kreditë për të vetëpunësuarit shpesh përfshihen në "kredi për qëllime të tjera" nëse nuk mund t'i atribuohen qartë ndonjë katagorie tjetër. Pavarësisht kësaj, sjellja ekonomike nga këta pjesëmarrës të tregut mund të ndryshojë shumë nga ajo e familjes tipike. Meqenëse informacioni mbi të vetëpunësuarit është i rëndësishëm për analizat ekonomike dhe financiare, statistikat e normave të interesit prezantojnë për herë të parë një informacion të rëndësishëm për analizën e kësaj kategorie që ka një peshë kyçe në bizneset në vend.

Rishikimit të përkufizimit për depozitat njëditore, kreditë qarkulluese dhe overdraftet. Për përcaktimin e flukseve të reja të depozitave njëditore, depozitave të shlyera me njoftim paraprak, borxhit të zgjeruar të kartave të kreditit, kredive qarkulluese dhe overdrafteve, aplikohet një përqasje e re nga ajo e përdorur për kategoritë e tjera të flukseve të reja. Këto kategori

⁴ "Udhëzuesi mbi raportimin dhe përdorimin e statistikave të normave të interesit" ofron informacion më gjithëpërfshirës për përdoruesit e këtyre statistikave.

karakterizohen nga një numër i madh fluksesh hyrëse dhe dalëse gjatë muajit. Rritjet dhe uljet në vlerë për këto llogari rrjedhin më së tepërmi nga arkëtimet dhe pagesat që lidhen me aktivitetin ekonomik të klientit dhe jo domosdoshmërisht me vendimmarrjen investuese të tij. Për më tepër, është e zakonshme që pjesa më e madhe e depozitave, overdrafteve, borxhit të zgjeruar të kartave të kreditit të kthehen gjatë periudhës. Për këtë arsye, sipas metodologjisë së re do të merret në konsideratë sasia *gjendje në datën e raportimit, i cili vlerësohet të jetë treguesi më i përshatshëm për përcaktimin e flukseve të reja.*

Kategorizimit të kredisë për korporatat jofinanciare sipas madhësisë së kredisë dhe periudhës fillestare të fiksimit të normës së interesit. Kreditë për korporatat jofinanciare ofrohen të dalluara sipas madhësisë së kredisë, duke zgjeruar informacionin për ekspertizën e kushteve të financimit të bizneseve. Vëllimi i kredisë konsiderohet të jetë një tregues i madhësisë së ndërmarrjes, si dhe ka një lidhje më të ngushtë me çmimin/normën e interesit të vendosur për financim. Kreditë për biznesin ndahen më tej, sipas periudhës fillestare të fiksimit të normës së interesit. Kjo mundëson investigimin më në detaje të transmetimit të ndryshimeve kryesore të normën bazë të interesit.

Kategorizimit të kredisë së re sipas shkallës së mbulimit me kolateral për individët dhe korporatat jofinanciare. Në sistemin e ri të raportimit, llojet e kredive, që konsiderohen të siguruara sipas specifikimit metodologjik, raportohen veçmas për të gjitha llojet e kredive përveç borxhit të zgjeruar të kartës së kreditit, kredive qarkulluese dhe overdrafteve dhe kredive për qëllime të tjera. Kategorizimi i kredisë sipas shkallës së mbulimit me kolateral lejon që normat e interesit të ndahen në grupe më homogjene rreziku. Kjo u siguron analistëve informacion shtesë për shkaqet e mundshme të ndryshimeve në normat e interesit. Për më tepër, të dhënat lejojnë analiza më të hollësishme se si rreziku i kredisë ndikon në mënyrën me të cilën bankat strukturojnë termat dhe kushtet e tyre, duke lejuar gjithashtu të nxirren përfundime në lidhje me kostot e financimit të huamarrësve.

TABELAT NË PUBLIKIM

Statistikat e normave të interesit u referohen depozitave dhe kredive të emëruara në 3 monedhat kryesore: Lek, Euro, Usd. Mbulimi përfshin vetëm depozitat dhe kreditë e kundërpasive rezidente në territorin e Shqipërisë. Aktiviteti me subjekte jorezidente është i përjashtuar. Informacioni mbi normat e interesit dhe sasi të koresponduese paraqitet i agreguar dhe organizohet në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1.1: Normat e interesit për depozitat në lek (sasi të gjendje)

Tabela 1.2: Normat e interesit për depozitat në euro (sasi të gjendje)

Tabela 1.3: Normat e interesit për depozitat në usd (sasi të gjendje)

Tabela 2.1: Normat e interesit për kreditë në lek (sasi të gjendje)

Tabela 2.2: Normat e interesit për kreditë në euro (sasi të gjendje)

Tabela 2.3: Normat e interesit për kreditë në usd (sasi të gjendje)

Tabela 3.1: Normat e interesit për kreditë dhe depozitat në lek (sasi të reja)

Tabela 3.2: Normat e interesit për kreditë dhe depozitat në euro (sasi të reja)

Tabela 3.3: Normat e interesit për kreditë dhe depozitat në usd (sasi të reja)

Të dhënat në Tabelat T 1.1 deri në T.1.3 u referohen normave të interesit mbi sasinë gjendje të depozitave në tre monedha: lek, euro, usd.

Sasia gjendje në fund të periudhës është përcaktuar si stoku i të gjitha depozitave të vendosura nga klientët, domethënë, individëve dhe KJF-ve, me institucionet paradepozituese dhe të stokut të të gjitha kredive të dhëna klientëve nga institucionet e kreditit. Norma e interesit për sasi të gjendje duhet të reflektojë nivelin mesatar të ponderuar të normës së interesit të aplikuar në stokun e depozitave ose kredive në kategorinë e instrumentit përkatës për periudhën referuese (domethënë ditën e fundit të punës të muajit). Ajo përfshin të gjitha kontratat në fund të periudhës që janë rënë dakord deri në periudhën e referencës.

Norma vjetore e rënë dakord (AAR) është norma e interesit të dakordësuar në mënyrë individuale midis një institucioni kreditimi dhe klientit të tij, konvertuar në baza vjetore dhe shprehur në përqindje vjetore.

Të dhënat në Tabelat T.2.1 deri në T2.3 u referohen normave të interesit të kredive mbi sasinë gjendje në tre monedha: lek, euro, usd. Normat e interesit për depozitat njëditore, depozitat e shlyera me njoftim paraprak, borxhit të zgjeruar të kartave të kreditit, kredive qarkulluese dhe overdrafteve reflektojnë normën mesatare të ponderuar të interesit mbi gjendjen e këtyre llogarive në datën e fundit të periudhës së referencës. Ato përfshijnë pozicionet aktuale të balancave të të gjitha kontratave të aprovuara deri në periudhën e referencës.

Të dhënat në Tabelat T.3.1 deri në T3.3 u referohen normave të interesit të kredive dhe depozitave mbi sasinë e re (fluks) në tre monedhat lek, euro, usd.

Flukset e reja për depozitat me maturitet të përcaktuar, kreditë konsumatore për individët, kreditë për blerje banese dhe qëllime të tjera, dhe për kredi për korporatat jofinanciare (Përveç kredive qarkulluese, oferdrafteve dhe borxhit të zgjeruar të kartave të kreditit), është përcaktuar si kontratë e re midis klientit dhe institucionit financiar.

PYETJET MË TË SHPESHTA

P.1: A regjistrojnë këto Tabela normat e reklamuar nga bankat?

Tabelat regjistrojnë normat mesatare të ponderuara (AAR), të dakorduara midis institucioneve të kredisë dhe klientëve, të cilat mund të mos jenë të njëjta me normat standarde të reklamuar. Diferenca përfshin huatë e rinegociuara, huatë me kushte preferenciale, si dhe metodologjinë themelore të përpilimit

statistikor (sipas kategorizimit të instrumenteve dhe jo produktit individual).

P.2: Si mund t'i krahasoj statistikat e reja të normave të interesit me seritë kohore të vjetra?

Pjesa më e madhe e kategorive kanë ndyshime të rëndësishme metodologjike si në përfshirje dhe mbulimin e kategorive ashtu edhe në mënyrën e përlllogaritjes. Duhet të bëhet kujdes kur krahasohen këto të dhëna duke iu referuar gjithmonë manualit të hartimit të normave të interesit sipas standardeve të BQE-së⁵.

P.3: Ku mund të gjej të dhëna për normat e interesit në vendet e tjera?

Të dhënat për vendet e tjera të zonës së euros dhe vendeve të BE-së gjithashtu mund të shkarkohen nga databaza statistikore e BQE-së⁶. BQE-ja gjithashtu publikon një statistikë të normave të interesit të bankës në zonën euro çdo muaj, dhe jep koment për zhvillimet financiare në Buletinin Ekonomik.

⁵ “Udhëzuesi mbi raportimin dhe përdorimin e statistikave të normave të interesit” ofron informacion më gjithëpërfshirës për përdoruesit e këtyre statistikave.

⁶ Databaza e statistikave të normave të interesit të BQE-së: <https://sdw.ecb.europa.eu/browse.do?node=9691123>